



RAPORT
MONITORIMI I SEKTORIT TË
MJEDISIT
ADMINISTRATA QENDRORE 2024





RAPORT

MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT

ADMINISTRATA QENDRORE - 2024

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771

Prill, 2025

Ky raport është një përpjekje e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë së Kosovës karshi aspekteve që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Kjo metodologji merr në konsideratë aktet ligjore dhe nënligjore që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit.

Aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi rregullon janë:

- Organet institucionale
- Aktet nënligjore
- Kapacitetet njerëzore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Pjesëmarrja publike
- Të dhënat mjedisore
- Mbikëqyrja dhe raportimi
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë këto aspekte për vitin 2024.



Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet përgjegjëse.

Zyrtarët e intervistuar kanë theksuar se burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe nënëgjendjen aktuale mjedisore.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT PËR ADMINISTRATËN QENDRORE

Kapacitetet administrative dhe të burimeve njerëzore në tërë sektorin që mbulon mjedisin dhe ndryshimet klimatike sipas Raportit të BE-së për Kosovën për vitin 2024 janë në nivel mjaft të ulët dhe paraqesin një pengesë të konsiderueshme për zhvillimin e duhur e progresiv të tij.

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (MMPHI) ka të themeluar 4 divizione:

- Divizioni i Ujërave
- Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale
- Divizioni për Mbeturina e Kimikate
- Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës

Ky departament nuk është përgjigjur lidhur me ndonjë ndryshim apo përmirësim gjatë vitit 2024.

Po ashtu nuk ka të dhëna të vitit 2024 lidhur me përgatitjen profesionale të shërbyesve, e as informata nëse janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore.

Gjithashtu nuk janë ofruar të dhënat për vitin 2024 lidhur me aspektin e mbështetjes për nivelin lokal në menaxhimin e çështjeve mjedisore, dhe as nëse janë zhvilluar udhëzuesit e paraparë me kornizën ligjore për vlerësime mjedisore dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore.

Departamenti për Inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI)

Ka raportuar se ka gjithsejtë 31 punonjës, prej të cilëve 2 janë në Zyrën e Udhëheqësit të Departamentit, 20 në Divizionin për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave dhe 9 në Divizionin për Inspektim të Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor.

Sipas shpjegimeve të dhëna ka nevojë për 18 punonjës shtesë, pas riorganizimit. Në këtë kuadër është theksuar se në këtë departament ka punonjës me profil jo adekuat për kryerjen e punëve. Sa i përket trajnimeve rreth kornizës ligjore është njoftuar se janë mbajtur disa trajnime gjatë vitit nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e Ligjit për inspektime të organizuara.

Krahas kësaj është bërë e ditur se nuk janë organizuar trajnime për nivelin lokal për kornizën ligjore. Për çështjet mjedisore, është theksuar se gjatë vitit 2024 ka pasur dy trajnime me organizatën IMPEL, rreth zbatimit të kornizës ligjore dhe bashkëpunimit ndërinstitutional për krime mjedisore.

Bashkëpunimi është vlerësuar i mirë me inspektorët e nivelit lokal për çështjet mjedisore, ku për rastet konkrete janë ofruar këshilla të ndryshme.

Ndërkohë nuk janë hartuar udhëzuesit për vlerësime mjedisore në menaxhimin e çështjeve mjedisore.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (MMPHI)

Ka të themeluara organet institucionale që i parasheh rregullorja përkatëse, përfshirë Divizionin e Planifikimit Hapësinor, Divizionin e Ndërtimit dhe Divizionin e Banimit. Lidhur me indikatorët për vitin 2024 nuk janë ofruar përgjigjet nga ky departament.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (MMPHI)

Ka njoftuar se të gjitha organet institucionale janë të themeluara, por se ka nevojë për fuqizim të kapaciteteve. Në këtë Autoritet numri i planifikuar i punëtorëve është 15, derisa numri aktual i punëtorëve është 8. Sipas përgjigjeve është i nevojshëm rekrutimi i stafit shtesë dhe trajnime të mëtutjeshme për punonjësit e këtij Autoriteti, meqë ka nevojë për ekspertizë të avancuar në fushën e menaxhimit mjedisor. Përgatitja profesionale për kryerjen e detyrave është vlerësuar si mesatare, ndërkohë që nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore me stafin e Autoritetit e as me nivelin lokal.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit (AMMK - MMPHI)

Në vitet paraprake ka bërë të ditur se numri i angazhuar i shërbyesve civil për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj nuk është i mjaftueshëm, dhe nuk ka njoftuar nëse gjatë vitit 2024 ka pasur përmirësime në këtë drejtim. Ngjashëm nuk janë ofruar informata edhe për indikatorët tjerë për periudhën e vitit 2024.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (AMMK-MMPHI)

Ka njoftuar se në këtë Institut numri i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, ngase në Sektorin për Zonat e Mbrojtura janë vetëm 2 punonjës dhe 1 tjetër në Sektorin për Biodiversitet. Në përgjigjen e ofruar thuhet se stafi ekzistues i IKMN është profesional, por i pamjaftueshëm. Sipas IKMN-së në vitin 2024 trajnimet rreth çështjeve ligjore e mjedisore nuk janë organizuar, derisa ka pasur pjesëmarrje në ligjëratat e Akademisë Evropiane për Natyrën. Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur mbështetje për nivelin lokal në menaxhimin e çështjeve mjedisore, dhe as nuk është zhvilluar ndonjë udhëzues përkatës.

Instituti Hidrometeorogjik i Kosovës (AMMK-MMPHI)

Në kuadër të cilit janë të themeluara Sektori për Meteorologji dhe Klimë, Sektori për Hidrologji, Sektori për Monitorimin e Ajrit, dhe Sektori i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave dhe Dheut ka njoftuar se numri i angazhuar i punonjësve nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Në përgjigje thuhet se ka nevojë për diversifikim të profileve profesionale dhe për trajnime specifike. Përgatitja profesionale është vlerësuar me notën 3.5 nga 5 të mundshme, pasi në varësi të sektorëve disa kanë përgatitje të duhur dhe disa u nevojiten trajnime shtesë. Trajnime rreth kornizës ligjore apo rreth çështjeve mjedisore nuk janë organizuar, as me stafin e as me nivelin lokal. Në pyetjen për mbështetjen që ky departament ofron për nivelin lokal në menaxhimin e çështjeve mjedisore është theksuar se ofrohen të dhëna të ndryshme të monitorimit që bën IHMK-ja.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” (AMMK-MMPHI)

Në vitet paraprake ka njoftuar se nuk ka staf të mjaftueshëm për mbulimin e gjithë territorit të parkut, derisa për vitin 2024 nuk ka ofruar përgjigje nëse ka pasur ndonjë përmirësim në këtë drejtim. Përgjigje nuk ka pasur as për indikatorët tjerë të pyetësorit.

Departamenti i Pylltarisë (MBPZHR)

Ka bërë të ditur se numri i angazhuar prej gjithsejtë 7 punonjësve nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur të gjitha përgjegjësitë institucionale, dhe se rreth 80% prej tyre kanë profilet e nevojshme profesionale. Sipas përgjigjeve janë organizuar 3 trajnime për zbatimin e legjislacionit dhe 2 sosh për hartimin e akteve nënligjore me projektin që zbatohet nga FAO, me c'rast pjesëmarrës kanë qenë edhe zyrtarët nga niveli lokal. Ky departament ka njoftuar se i ofron mbështetje nivelit lokal sidomos sa i përket themelimit të vendgjueve të përbashkëta në komuna dhe dhënien e pëlqimeve përkatëse për planet menaxhuese 10 vjecare dhe planet vjetore të këtyre vendgjueve të përbashkëta.

Drejtoria për Menaxhim me Pyje (MBPZHR)

Në vitet e mëparme ka njoftuar se numri i shërbyesve civil për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj nuk është i mjaftueshëm dhe se stafi ka profilet e nevojshme profesionale. Nuk ka përgjigje nëse ka pasur përmirësime në këtë drejtim gjatë vitit 2024.

Drejtoria për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko – Turizëm (MBPZHR)

Më parë ka bërë të ditur se numri i punonjësve është i pamjaftueshëm, dhe nuk ka ofruar përgjigje nëse ka pasur përmirësime në këtë drejtim gjatë vitit 2024.

KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore e mjedisit në Kosovë përfshin një sërë ligjesh, rregullash dhe politikash që synojnë mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit. Kjo kornizë ligjore synon të sigurojë mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në Kosovë, duke harmonizuar zhvillimin ekonomik me ruajtjen e natyrës dhe burimeve natyrore.

Kapacitetet e autoriteteve mjedisore si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal për të zbatuar dhe fuqizuar acquis mjedisor, sipas Raportit të BE-së për Kosovën (2024) janë ende shumë të kufizuara, gjë që pengon seriozisht progresin në këtë sektor.

Departamentet që kanë përgjegjësi për çështjet mjedisore edhe gjatë vitit 2024 kanë dhënë vlerësime të ndryshme nëse kjo kornizë është e konsoliduar dhe nëse e njëjta është e harmonizuar me direktivat e BE-së.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në përgjigjen e tij ka bërë të ditur se disa ligje janë duke u rishkruar për shkak të nevojës për plotësimin apo ndryshimin e tyre.

Sipas këtij Instituti, Ligji për mbrojtjen e natyrës është duke u rishkruar me qëllim të përafrimit të dispozitave të tij me legjislacionin e BE-së.

Njohuritë e stafit mbi kornizën ligjore janë vlerësuar me notën 4 nga 5 që ka qenë nota maksimale. Ndërkohë nuk ka pasur përgjigje nëse janë hartuar të gjitha aktet nënligjore.

Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor ka vlerësuar se korniza ligjore mjedisore gjatë vitit 2024 nuk ka qenë mirë e konsoliduar, pasi që ka ligje që ndërhyjnë në njëra tjetrën dhe se në raste të caktuara kanë mos pajtueshmëri.

Sipas këtij departamenti, ka hapësirë për harmonizimin e legjislacionit vendor rreth planifikimit dhe menaxhimit mjedisor me legjislacionin e BE-së. Njohuritë e stafit lidhur me këtë kornizë ligjore janë vlerësuar si të mira përkatësisht me notën 3 nga 5 të mundshme. Gjithashtu është theksuar se Inspektorati ka vetëm një ligj dhe se i njëjti nuk ka akte nënligjore.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës lidhur me konsolidimin e kornizës ligjore mjedisore ka vlerësuar se përgjigjet duhet të ofrohen nga Departamenti i Mjedisit në MMPHI. Ky Institut ka pohuar se legjislacioni mbi veprimtarinë hidrometeorologjike është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, dhe me rregulloren e WMO. Njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore janë vlerësuar me notën 3 nga 5 të mundshme. Aktet e parapara nënligjore nuk janë hartuar gjatë vitit 2024.

Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore nuk ka dhënë vlerësime nëse korniza ligjore mjedisore është mirë e konsoliduar, dhe nëse e njëjta është e harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Njohuritë e stafit lidhur me kornizën respektive ligjore janë vlerësuar si mesatare, duke vënë në pah nevojën për trajnime shtesë.

Departamenti i Pylltarisë (MBPZHR) ka vlerësuar se korniza ligjore është pjesërisht e konsoliduar pasi ka ndeshje dispozitash ndërmjet Ligjit për Pyje, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjit për Menaxhimin e Pronës Publike.



Sipas këtij departamenti Ligji i Pyjeve është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe se stafi përkatës ka njohuri të shkëlqyeshme rreth kornizës ligjore.

Gjithashtu është theksuar se shumica e akteve nënligjore janë hartuar dhe se disa sosh janë në procedurë të aprovimit, dhe se mos aprovimi i tyre ka ndodhur për shkak të ndeshjes së dispozitave të Ligjit për Pyje dhe Ligjit për Menaxhimin e Pronës Publike.

DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT, PROGRAMET, PROJEKTET DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, institucionet përkatëse kanë hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm.

Sipas raportit të BE-së për Kosovën, për vitin 2024, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rishikuar dhe miratuar strategjitë, planet e veprimit dhe legjislacionin përkatës për të siguruar konsistencën me objektivat e Agjendës së Gjelbër dhe zbatimin e angazhimeve sipas Udhërrëfyesit të Dekarbonizimit të Komunitetit të Energjisë.

Po ashtu reformat strukturore vazhdojnë të vonohen. Angazhimi dhe financimi i pamjaftueshëm politik përbëjnë sfidat kryesore për zbatimin e kornizës strategjike, dhe sipas BE-së, miratimi i strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm për periudhën 2022-2033 mbetet në pritje, teksa përafrimi i plotë me Direktivat e BE-së për Përgjegjësinë Mjedisore dhe për Krimin ende nuk është përfunduar.

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave në vitet paraprake pat bërë të ditur se Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit është në rishikim, dhe nuk ka ofruar të dhëna nëse ka pasur përparim në vitin 2024.

Departamenti për Inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka ofruar të dhëna nëse janë zhvilluar projekte për mbrojtjen e mjedisit dhe ka konfirmuar se nuk ka ndërmarrë masa për mbrojtjen e mjedisit.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit nuk ka ofruar përgjigje.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore ka theksuar rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Planin e Veprimit 2023-2025, teksa si projekte ka listuar Pastrimin e shtretërve të lumenjve 2024-2025 për mbrojtjen e ujërave. Te masat ka përmendur zonat mbrojtëse për ujërat.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit nuk ka ofruar përgjigje.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës për vitin 2024 nuk ka informuar lidhur me planet dhe projektet kapitale. Te masat janë veçuar shenjëzimi i zonave të mbrojtura në katër komuna, propozimi i zonave për mbrojtje ligjore në dy komuna, pastaj vendosja e platformave për zogjtë shtegtarë, etj.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” nuk është përgjigjur.

Instituti Hidrometeorogjik i Kosovës (AMMK-MMPHI) ka pohuar se Strategjia e zhvillimit të veprimtarisë hidrometeorologjike në Kosovë 2022-2032 ende nuk është miratuar, derisa ka listuar pesë projekte kapitale sektoriale, por jo edhe masat e parapara.

Departamenti i Pylltarisë ka pohuar se një numër planesh janë kompetencë e APK-së, dhe ka listuar Programin për Menaxhimin e Faunës së Egër dhe Gjuetisë, dy Plane Menaxhuese të Vendgjuetive (10 vjeçar), Planin vjetor të menaxhimit të vendgjuetive të përbashkëta, dhe ka konfirmuar se nuk ka projekte kapitale për çështje mjedisore, apo masa adekuate.

Drejtoria për Menaxhim me Pyje nuk është përgjegjur.

Drejtoria për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko – Turizëm (MBPZHR) nuk është përgjegjur.

MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave nuk është përgjegjës për vitin 2024.

Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor ka konfirmuar se ka raste të çrregullimeve mjedisore nga aktivitetet ilegale të personave fizikë dhe juridikë, përfshirë eksploatimin ilegal të inerteve të lumenjve, eksploatimin ilegal të gurëve gëlqeror, ndërtimet ilegale dhe prerja ilegale e pyjeve brenda parqeve kombëtare. Në zonat e parqeve kombëtare veprimet e palejuara përfshijnë ndërtimet pa leje, prerjet ilegale të pyjeve, uzurpim të pronave, etj.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit nuk është përgjegjës.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore ka pohuar se janë identifikuar raste të eksploatimit të rrjedhave ujore, përkatësisht në shtretër të lumenjve është identifikuar eksploatimi i sedimenteve.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit nuk është përgjigjur.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka raportuar se Raporti për gjendjen e natyrës është hartuar dhe publikuar për periudhën 2018-2021. Në këtë raport theksohet se gjendja e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit në Kosovë është jo e kënaqshme dhe e kushtëzuar nga faktorët biotik dhe abiotik.

Sipas raportit përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e vendit.

Ndër konkluzionet që dalin nga ky raport ceken sfidat si implementimi i pjesshëm i ligjeve në fuqi që lidhen me çështjen e ruajtjes së vlerave natyrore dhe biodiversitetit; mungesa e institucioneve për mbrojtjen e natyrës; numri i pamjaftueshëm i stafit profesional në IKMN; numri i pamjaftueshëm i inspektorëve për mbrojtje e natyrës, mungesa e stafit në drejtoritë e Parqeve Kombëtare dhe në organet tjera menaxhuese për zonat e mbrojtura; etj.

Sipas IKMN, monitorohet gjendja e larmisë biologjike dhe peizazhore, dhe gjendja e zonave të mbrojtura, por për vitin 2024 nuk janë ofruar të dhënat për rastet e identifikuara të çrregullimeve mjedisore.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” nuk është përgjegjës.

IHMK ka pohuar se publikohen njoftime për vërshime, dhe publikohet vjetari hidrometeorologjik.

Departamenti i Pylltarisë nuk është përgjegjës në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria për Menaxhim me Pyje nuk është përgjegjës.

Drejtoria për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko – Turizëm (MBPZHR) nuk është përgjegjës.

SIPAS TË DHËNAVE TË PUBLIKUARA NGA MMPHI, TASK FORCA E GJELBËR GJATË VITIT 2024:

23

aksione të ndërmarra në terren në zona të ndjeshme dhe të mbrojtura;

32

pajisje të rënda, përfshirë 50 ekskavatorë, kamionë dhe makineri janë sekuestruar;

6

separacione të paligjshme janë mbyllur;

25

urdhëresa për ndalimin e aktiviteteve të paautorizuara të lëshuara;

30

gjoba administrative për shkelje të ligjit për mjedisin të shqiptuara;

25

raste të dorëzuara në Prokurori;

390

raste të inicuar në gjykata për ndërtime të paligjshme nga APK, me mbi 200 vendime të marra nga gjykata;

30

zona të reja janë përpunuar për mbrojtje.

SISTEMET E MONITORIMIT TË MJEDISIT

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka bërë të ditur se të dhënat për sistemet e monitorimit të mjedisit janë të publikuara në ueb faqen e AMMK.

Përmbledhja e gjetjeve kryesore të raportit për gjendjen e mjedisit 2022 – AMMK, të publikuar në gusht të vitit 2024:

Ajri - Të dhënat nga monitorimi, përmbajnë të dhëna për tejkalimet e vlerave maksimale të lejuara për disa parametra e në veçanti për PM10 dhe PM2.5, dhe kjo kryesisht gjatë sezonit të dimrit. Numri më i madh i ditëve me tejkalime është regjistruar në stacionet matëse në Prishtinë Rilindja (59), Obiliq (40), Pejë (41) dhe Gjilan (52). Sa i përket trendit të koncentrimit vjetor të parametrave të monitoruar, bazuar në të dhënat vjetore për periudhën 2013-2022, vërehet një rënie e ndjeshme e koncentrimit të ndotësve e që mund të ndërlihet edhe me masat që janë ndërmarre për reduktimin e ndotjes.

Sa i përket emetimeve në ajër, sipas vlerësimit të bazuar në konsumin e lëndëve djegëse, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO₂ dhe SO₂ është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM_{2.5}, PM₁₀, pluhurit total dhe monoksidit të karbonit (CO), burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet rezidenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO₂ pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese dhe e ndërtimit është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla.

Uji - *Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja, që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve dhe fertilizerëve në bujqësi, dëmtimit të shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve si dhe nga ndërtimet ilegale. Gjatë vitit 2022, monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore është realizuar në 54 pika monitoruese në lumenj. Treguesit e cilësisë së ujërave të prezantuar në këtë raport, tregojnë për prani të ndotësve organik në ujërat e lumenjve.*

Monitorimi i sasisë së ujërave është realizuar në 25 stacione matëse, sa i përket nivelit H (cm) dhe 8 stacione matëse sa i përket prurjeve Q (m³ /sec). Kosova ende nuk ka monitorim të rregullt të cilësisë së ujërave të liqeneve dhe ujërave nëntokësore, sikurse që nuk ka as monitorim biologjik të ujërave sipërfaqësore. Po ashtu në Kosovë ende nuk është i zhvilluar plotësisht sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura edhe pse gjatë vitit 2022 ka pasur progres në këtë fushë. Trajtimi i ujërave të ndotura mbetet ende në shkallë të ulët me vetëm 25% nga tërë sasia e ujërave të ndotura.

Toka - Aktualisht Kosova nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulueshmërisë së tokave është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. Bujqësia, konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokave bujqësore, që vije si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kimikateve tjera për trajtimin e tokave.

Po ashtu edhe deponitë sanitare dhe ilegale të mbeturinave, industritë aktive dhe ato të vjetra, janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kimikateve, që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

Menaxhimi i Mbeturinave - Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori është vlerësuar të jetë 248 kg/banorë/vit. Aktualisht në nivel nacional grumbullohen rreth 90% të mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohen në deponi sanitare, ndërsa ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes së mbeturinave në burim si dhe riciklim të mbeturinave. Në vitin 2022 shënohet një rritje e deponimit të mbeturinave në sasi prej 43,623 ton, apo 9.77% më shumë krahasuar me vitin paraprak 2021. Menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës nuk është i mirë dhe ndër problemet kryesore janë mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara si dhe mbulimi jo adekuat i mbeturinave.

Në kuadër të përbërjes së mbeturinave, mbeturinat organike marrin pjesë me 30.4%, plastika 20%, letër dhe karton 15%, mbeturinat e gjelbra me 5%, tekstili 5%, qelqi 5%. Aktivitetet për ndarjen në burim, trajtimin e mbeturinave, riciklimin e mbeturinave dhe aspektet tjera që ndërlidhen me ekonominë qarkore ende janë në një shkallë të ulët.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti - Gjatë vitit 2022 regjistri kombëtar i zonave të mbrojtura është shtuar edhe për 12 zona të reja, duke e rritur numrin e zonave të mbrojtura në 260 zona, me një sipërfaqe prej 126,115.8 ha ose 11.6% e territorit të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore - Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare që realizohen përmes gurëthyesve, është një nga format më të shpeshta të shfrytëzimit të resurseve natyrore në Kosovë. Gjatë vitit 2022 janë lëshuar 232 licenca për shfrytëzim të gurit dhe 170 licenca për hulumtime të rezervave të gurit.

Të dhënat flasin se ka edhe operatorë ilegal që merren me këtë veprimtari. Bazuar në vlerësimet e realizuara, sipërfaqet e degraduara të lumenjëve nga shfrytëzimi i inerteve janë në rritje.

Prodhimi total i ujit të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2022 ka qenë 156,8 milion m³, ndërsa sasia e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi në vitin 2022 ishte 93.34 milion m³ ujë. Sa i përket pjesëmarrjes së llojeve të burimeve të ujit në të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2022, 58% e tyre janë marrë nga liqenet akumuluese, 28% nga lumenjët, 5% nga burimet dhe 10% nga puset.

Vlerësohet se gjatë vitit 2022, sipas planifikimit janë shfrytëzuar rreth 145,705 m³ dru nga pyjet publike. Prerjet ilegale mbeten një nga sfidat kryesore të sektorit të menaxhimit të pyjeve.

Gjatë vitit 2022, nga Njësitë Komunale të Pylltarisë janë konfiskuar 1,789.86 m³ masë drunore, nga e cila 151.92 m³ dru teknik dhe 1,637.94 m³ dru zjarri. Kurse nga Inspeksioni Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë të APK-së janë konfiskuar gjithsejtë 225.64 m³ masë drunore, (prej tyre 194.67 m³ dru zjarri dhe 30.97 m³ dru teknik).

Gjatë vitit 2022 nga zjarret pyjore janë përfshirë 1,596.98 ha pyje dhe toka pyjore, nga të cilat 976.12 ha në pyje publike dhe 620.86 ha në pyje private. Nga buxheti APK-së janë pyllëzuar 111.04 ha sipërfaqe me pyje.

Shëndeti publik - Numri i sëmundjeve ambientale të regjistruara, gjatë vitit 2022 ka shënuar rritje. Sipas vlerësimeve të bërë nga të dhënat e analizuara, është konstatuar se ka pasur 105491 raste me shumë të sëmundjeve ambientale për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ose rreth 46.5% me shumë.

Sipas vlerësimeve ekspozimi ndaj koncentrimit të PM2.5 ishte i ndërlidhur me 359 vdekje të parakohshme. Ekspozimi ndaj koncentrimit të NO2 ishte i ndërlidhur me 264 vdekje të parakohshme, ndërsa ekspozimi ndaj koncentrimit të O3 ishte i ndërlidhur me 135 vdekje të parakohshme.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit të realizuara nga KRU-të, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve gjatë vitit 2022, ka qenë në përputhje me standardet e ujit të pijshëm me një përputhshmëri prej 98.5% për testet bakteriologjike dhe 94.7% për testet kimike.

Krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, gjatë vitit 2022, ishte më e mirë për përshtatshmëri bakteriologjike dhe më e dobët për përputhshmëri fiziko-kimike.

Mjediset e rrezikuara - në mënyrë më specifike në raport është trajtuar gjendja mjedisore në zonat e veprimit të operatorëve të KEK, Feronikel dhe Sharrcem, ku janë trajtuar aspektet e përgjithshme të menaxhimit të mjedisit, duke përfshirë emetimet në ajër, shkarkimet në ujë, menaxhimi i mbeturinave industriale, si dhe aspekte tjera mjedisore. Në raport janë prezantuar edhe të dhëna të përgjithshme edhe për 17 lokacione të tjera të cilat konsiderohen si hotspote mjedisore, e që janë krijuar kryesisht si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide, herbicide etj.

Masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit - Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit nacional me direktivat e BE-së, megjithëse sfidë mbetet implementimi i tyre.

Janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisor si në nivelin qendror dhe atë lokal, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Edhe pse gjatë vitit 2022 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisin janë ende në numër shqetësues.

Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë.

SISTEMET E MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE MJEDISORE

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka rishikuar dhe përgatitur “Programin për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor të Republikës së Kosovës 2023-2027”.

Qëllimi primar i këtij programi është të mundësojë: mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin dhe shfrytëzimit e të dhënave për gjendjen e mjedisit në Republikën e Kosovës, përmes një sistemi modern dhe efikas në nivelin nacional, që do të ofrojë një pasqyre reale të gjendjes së mjedisit dhe problemeve kryesore mjedisore.

Përmes këtij sistemi po ashtu do të mundësohet përcjellja e gjendjes së mjedisit dhe trendëve të zhvillimeve mjedisore, analiza, vlerësimi dhe raportimi real për gjendjen e mjedisit në nivel vendi me qëllim të hartimit dhe miratimit të vendimeve strategjike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për sektorin e mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga ky sistem do të sigurohen edhe të dhëna dhe analiza të nevojshme mjedisore edhe në kuadër të përmbushjes së obligimeve dhe standardeve mjedisore në procesin e integritimeve evropiane dhe bashkëpunimit me institucionet mjedisore të Bashkimit Evropian.

Objektivat kryesore të dokumentit janë:

- Avancimi i sistemit informativ mjedisor dhe digjitalizimi i tij;
- Përmirësimi i sistemit për monitorimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit përmes lehtësimit të procesit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave;
- Përmirësimi i informimit të politikëbërësve, publikut të gjerë dhe grupeve tjera të interesit me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe vlerësimit më të mirë të nevojave për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Me qëllim të kompletimit dhe funksionalizimit të plotë të Sistemit Informativ Mjedisor duhet të finalizohen disa nga veprimet/projektet që tani më janë në proces të realizimit dhe ndërmerren veprime tjera për zhvillimin e sistemeve, databazave dhe aplikacioneve shtesë.

Nuk ka pasur raportim për përmirësimet e arritura në këtë aspekt gjatë vitit 2024.

BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE

Departamentet e ndryshme të nivelit qendror kanë raportuar se bashkëpunimi është i kënaqshëm me ministritë dhe institucionet tjera publike përfshirë pushtetin lokal në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe strategjive mjedisore, derisa kanë pranuar se nga organizatat e shoqërisë civile kontributi kryesisht merret gjatë procesit të diskutimit publik, përfshirë edhe faktin që aktivistët në raste të caktuara përfshihen edhe në grupet punuese. Nuk ka pasur njoftime nëse gjatë vitit 2024 ka pasur përmirësime të ndjeshme në këtë drejtim.

LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE

Institucionet përgjegjëse të nivelit qendror nuk kanë ofruar të dhëna për vitin 2024 lidhur me këtë kapitull të hulumtimit.

PËRFUNDIME

Gjendja aktuale e mjedisit në Kosovë, ashtu siç e pranojnë edhe zyrtarët e lartë qeveritarë, nuk është e mirë. Dhe përmirësimet në këtë aspekt nuk mund të realizohen pa forcimin e kapaciteteve institucionale por edhe komunikimin e duhur me publikun, me qëllim të ndërgjegjësimit. Ky proces nuk mund të jetë i suksesshëm pa fuqizimin e organeve shtetërore dhe pa një transparencë të përmirësuar respektivisht me mbylljen e institucioneve deri në nivelin e injorimit të përgjegjësië karshi qytetarëve.

Pjesa dërmuese e organeve kompetente të nivelit qendror kanë theksuar se numri i angazhuar i shërbyesve civil për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj nuk është i mjaftueshëm, dhe se ka nevojë për bashkëpunim më të plotë me nivelin lokal në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave natyrore.

Për kornizën ligjore mjedisore është shprehur qëndrimi se është e pjesërisht konsoliduar, por se ka nevojë edhe për plotësim-ndryshime me qëllim të harmonizimit me direktivat e BE-së.

Por ka vërejtje edhe për ndeshje mes dispozitave të ligjeve të caktuara.

Të dhënat e grumbulluara në kuadër të hulumtimit lidhur me dokumentet e planifikimit, programet, projektet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit janë tejet simbolike, dhe njëherësh vërtetojnë mungesën e kapaciteteve dhe nevojën e përmirësimit të dukshëm të punës së organeve përgjegjëse në këtë aspekt. Situatë e ngjashme është edhe sa i përket mbikëqyrjes inspektive dhe raportimit mjedisor.

Të dhënat për sistemet e monitorimit të mjedisit janë të publikuara në ueb faqen e AMMK-së, por jo edhe në kohë reale.

Gjetjet kryesore të raportit për gjendjen e mjedisit 2022 të AMMK-së, të publikuar në gusht të vitit 2024, ndër të tjerash bëjnë të ditur se nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë, dhe se çështja e mjedisit në Kosovë ende ka nevojë për përmirësime të dukshme në të gjitha aspektet.



Edhe sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore kërkojnë përmirësim të mëtejshëm ngase nuk janë të kompletuara, dhe njëkohësisht nevojitet staf adekuat.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes ministrive dhe institucioneve tjera publike në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe strategjive mjedisore nga organet përgjegjëse është vlerësuar si i kënaqshëm, derisa pjesëmarrja e publikut në hartimin e dokumenteve mjedisore është vlerësuar si mesatar.

Ngjashëm si në kapitujt tjerë, institucionet përgjegjëse duhet të shtojnë përpjekjet për raportim më efikas edhe sa i përket licencimit dhe lëshimit të lejeve mjedisore.

REKOMANDIME

Duke qenë se nga viti paraprak nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme, rrjedhimisht edhe në këtë raport janë përsëritur rekomandimet e dhëna për nivelin qendror lidhur me çështjet mjedisore.

- Të rritet transparenca e institucioneve për çështjet mjedisore;
- Çështja e mjedisit në Kosovë të trajtohet me prioritet më të lartë;
- Të hartohen dhe miratohen pa vonesa legjislacioni dhe politikat e duhura publike për mjedisin;
- Të intensifikohen angazhimet sa i përket harmonizimit të legjislacionit me direktivat e BE-së;
- Të përmirësohet niveli i hartimit, miratimit dhe zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit në të gjithë sektorët mjedisorë;
- Të shtohen aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse për mbrojtjen e natyrës;
- Organet shtetërore përgjegjëse të sigurojnë mekanizma të qëndrueshëm të financimit për projektet mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit;

- 
-
- Të ndërtohet një sistem i kompletuar i informimit mjedisor, ku hisedarët dhe publiku informohen në kohë reale sa i përket gjendjes mjedisore;
 - Të shtohen përpjekjet për ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
 - Të përmirësohet bashkëpunimi me shoqërinë civile;

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-së synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.



DEKLARATA E VIZIONIT

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

DEKLARATA E MISIONIT

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.



WWW.ECMANDRYSHE.ORG